



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2023:234081

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05706731

KPPP.nr.1737/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbartimore të kreditorit 1. V.P. nga Fieri Republika e Shqipërisë me banim në rr. “Konferenca e Pezës” p.n. Fier, 2. Leksi Tupe nga Fieri Republika e Shqipërisë me banim në rr. “Konferenca e Pezës” p.n. Fier, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Muhamet Mujaj, avokat nga Prishtina, kundër debitorëve: 1. Shoqëria “TPD – Trading Petrol & Drilling” SH.A., me seli në rr. “Ibrahim Rugova” Sky Tower, kati 10, nr.102, Tiranë, Republika e Shqipërisë; 2. Shoqëria “IONIAN Refining & Trading Company IRTC” SH.A. me seli në rr. “Papa Gjon Pali II” ABA Busines Center, kati 8, Tiranë, Republika e Shqipërisë; personit të tretë 3. “Nera Petrol” SH.P.K. me numër identifikues 81154863, me seli në rr. “Zenun Beqa” nr. 19, Ferizaj, 4. “Patroni” SH.P.K. me numër unik identifikues 811254797 me seli në fshatin Miradi e Ulët, p.n., Fushë Kosovë dhe 5. “Veda – 2 Petrol” SH.P.K. me numër unik identifikues 810674433 me seli në rr. “4 Korriku”, Viti, për shkak të përmbartimit të borxhit sipas Urdhrit Përmbartimor P.nr.484/23 të datës 10.07.2023 të Përmbartuesit Privat Bardh B. Tasholli, jashtë seancës me datën 20.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore, për të vendosur sipas prapësimit të personave të tretë “Nera Petrol” SH.P.K. dhe “Veda – 2 Petrol” SH.P.K., të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.484/23 të datës 10.07.2023 të Përmbartuesit Privat Bardh B. Tasholli.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda së bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.

A r s y e t i m

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës KPPP.nr.1737/23 në çështjen përmbartimore të kreditorit “V.P. dhe Leksi Tupe kundër “Shoqëria TPD – Trading Petrol &Drilling” SH.A. dhe “Shoqëria IONIAN Refining &Trading Company IRTC” SH.A. dhe personave të tretë “Nera Petrol” SH.P.K., “Patroni” SH.P.K. dhe “Veda – 2 Petrol” SH.P.K., vlerësoi kompetencën lëndore të gjykatës dhe gjeti se Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas prapësimit lidhur me këtë çështje.

Meqenëse në rastin konkret çështja përmbartimore zhvillohet në mes të kreditorit si person fizik dhe debitorit dhe personave të tretë si persona juridik, me kërkesë në bazë të titullit ekzekutiv – Aktgjykimit CN.nr.155/23 të datës 24.05.2023 me të cilin është njohur vendimi i huaj – Aktgjykimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Republika e Shqipërisë, me numër protokollit Nr.21234-01575-62-2017 (1667/68 dhe Nr.62-2018-1794 (456) i datës 04.04.2018.

Në këtë drejtim neni 13 par.1 nën par. 1.1 të Ligjit Nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale thekson në mënyrë shprehimore se Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: *“kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*, dhe nën par. 1.2 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbartimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate”*, rezulton se kjo çështje nuk bie në kompetencë lëndore të kësaj gjykate për vendosje, pasi që në rastin konkret në cilësinë e kreditorit janë personat fizik V.P. dhe Leksi Tupe, ndërsa në cilësinë e debitorit është personi juridik, andaj në kuptim të nenit 5 par.5 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, kompetente për vendosjen sipas prapësimit të debitorit “Nera Petrol” SH.P.K. me seli në Ferizaj dhe “Veda – 2 Petrol” SH.P.K. me seli në Viti, kompetente për vendosje është Gjykata Themelore në Ferizaj.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 dhe 19 të LPK-së, lidhur me nenin 17 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore dhe nenin 13 par.1 nën par.1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1737/23, datë 20.05.2024.

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate